

TË KEQUSHQYER DREJT EUROPËS



RAPORT MONITORIMI

Shtator 2025



QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

AUTOR
LORELA ALIA

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	3
2.	METODOLOGJIA	3
3.	ANALIZA MBI KAPITULLIN 12, "SIGURIA USHQIMORE, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE"	5
4.	ANALIZA MBI KAPITULLIN 28, "MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETI PUBLIK"	8
5.	INCIDENTET DHE SKANDALET E SIGURISË USHQIMORE NË SHQIPËRI (2024–2025)	10
6.	SHPËRBËRJA E AKU-SË DHE REFORMIMI INSTITUCIONAL NË KONTROLLIN USHQIMOR	13
7.	ANALIZA KRAHASUESE E SIGURISË USHQIMORE NË SHQIPËRI DHE VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR.....	15
8.	ANALIZË E PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTLIGJIT SHQIPTAR "PËR KONTROLLET ZYRTARE" ME RREGULLOREN (BE) 2017/625.....	19
9.	GJETJET KRYESORE	22
10.	REKOMANDIMET.....	23
11.	REFERENCA.....	24



1. HYRJE

Procesi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE) zhvillohet përmes përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire*, të ndarë në 35 kapituj negociues. Dy nga kapitujt më kritikë në këtë proces janë **Kapitulli 12** dhe **Kapitulli 28**, të cilët lidhen drejtpërdrejt me shëndetin publik, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Kapitulli 12, “Siguria Ushqimore, Politika Veterinare dhe Fitosanitare”, bën pjesë në **Grupkapitullin V “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”,** i cili **nuk është hapur ende për negociata.** Ai mbulon një gamë të gjerë çështjesh, nga siguria e ushqimit për njerëzit dhe kafshët, e deri tek kontrolli i sëmundjeve, përdorimi i pesticideve dhe shëndeti i bimëve.

Në të kundërt, **Kapitulli 28, “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik”** është pjesë e **Grupkapitullit III “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse”,** i cili **është hapur zyrtarisht në Maj 2025.** Ky kapitull fokusohet në garantimin e të drejtave të konsumatorit, mbrojtjen nga produktet e pasigurta, standardet për barnat dhe përgjigjen ndaj kërcënimeve shëndetësore ndërkufitar

2. METODOLOGJIA

Analizë Dokumentare

Në kuadër të kësaj pune kërkimore është realizuar një analizë dokumentare që mbështetet në burime të ndryshme ligjore, institucionale dhe praktike. Fillimisht, është shqyrtuar legjislacioni shqiptar për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, i cili përcakton kuadrin normativ për garantimin e cilësisë së produkteve ushqimore, kontrollin e tyre në treg dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Ky legjislacion harmonizohet gradualisht me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, duke synuar afrimin me standardet evropiane në fushën e sigurisë ushqimore.



Një vëmendje e veçantë i është kushtuar rregulloreve kyçe të BE-së, përfshirë Rregulloren (BE) 2017/625, e cila rregullon kontrollin zyrtar përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor, si dhe Rregulloren (KE) 178/2002, e cila vendos parimet e përgjithshme dhe kërkesat bazë të legjislacionit ushqimor dhe krijon Autoritetin Evropian për Sigurinë Ushqimore (EFSA). Këto dokumente përfaqësojnë shtyllat kryesore të politikës evropiane për sigurinë ushqimore dhe shërbejnë si pikë reference për reformat që ndërmerren në Shqipëri.

Gjithashtu, janë marrë në analizë raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit për periudhën 2023–2025, të cilat japin një panoramë të qartë mbi progresin dhe sfidat e vazhdueshme në përafrimin me standardet e BE-së. Raportet përmbajnë vlerësime mbi funksionimin e institucioneve, kapacitetet e kontrollit zyrtar, si dhe nivelin e zbatimit të legjislacionit ekzistues.

Për më tepër, janë shqyrtuar të dhënat e sistemit të paralajmërimit të shpejtë për ushqimet dhe ushqimin për kafshët (RASFF), të cilat ofrojnë informacione të rëndësishme mbi rastet e ndotjes apo shkeljeve të standardeve të siguri së ushqimore. Në këtë kuadër janë evidentuar edhe disa raste konkrete të skandaleve ushqimore të ndodhura në Shqipëri gjatë viteve 2024–2025, të cilat kanë ndikuar në perceptimin e publikut për sigurinë ushqimore dhe kanë nxitur diskutime mbi efektivitetin e mekanizmave të kontrollit dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Analizë Krahase Rajonale

Është realizuar një vlerësim krahasues i gjendjes së siguri së ushqimore në Shqipëri ndaj 5 vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor (Serbi, Maqedoni e Veriut, Bosnjë-Hercegovinë, Mali i Zi, Kosovë). Janë përdorur 6 indikatorë të matshëm,

1. Përputhja me *acquis communautaire*
2. Gjurmueshmëria
3. Kapacitetet laboratorike



4. Kontrolli kufitar i bazuar në risk
5. Transparenca dhe raportimi publik
6. Informalitet (invers)

Me vlerësim nga 1 (i dobët) deri në 5 (i përputhshëm në nivel BE).

Vlerësimi bëhet në një shkallë nga 1 në 5, ku:

- 1 = shumë i ulët / mungesë totale
- 2 = përputhje e pjesshme / fragmentare
- 3 = mesatar / me boshllëqe, por funksional
- 4 = përputhje e mirë / zbatim konsistent
- 5 = përputhje e plotë me standardet e BE

Ky model vlerësimi ofron një pamje të strukturuar dhe të krahasueshme për të identifikuar problematikat e ketyre dy kapitujve.

3. ANALIZA MBI KAPITULLIN 12, “SIGURIA USHQIMORE, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE”

Kapitulli 12¹ i *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian përqendrohet në sigurinë ushqimore, politikën veterinare dhe masat fitosanitare. Ky kapitull është ndër më teknikët dhe më të ndërlikuarit për vendet candidate për anëtarësim në BE, sepse kërkon jo vetëm përafrim të legjislacionit me rregulloret evropiane, por gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme administrative, laboratorike dhe të kontrollit në të gjithë zinxhirin ushqimor. Ai përfshin rregullat për higjienën e ushqimeve, sigurinë e ushqimit për kafshë, mbrojtjen e konsumatorit, kontrollin e sëmundjeve të kafshëve, përdorimin e pesticideve dhe cilësinë e materialeve të mbrojtjes së bimëve. Zbatimi efektiv i këtij kapitulli ka rëndësi kritike jo vetëm për shëndetin publik,

¹ European Commission. (2017). *Regulation (EU) 2017/625 on official controls and other official activities*. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017R0625>



por edhe për funksionimin e tregut të brendshëm, konkurrueshmërinë e prodhuesve vendas dhe aftësinë për të eksportuar drejt BE-së.²

Në rastin e Shqipërisë, kuadri ligjor nuk është ende i përafruar me Rregulloren e Përgjithshme për Ushqimin dhe Rregulloren për Kontrollin Zyrtar (OCR). Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), si organi përgjegjës për kontrollin dhe inspektimin, ka nisur procesin e rishikimit të sistemit të të dhënave (AKU-net), por ende nuk ka një sistem funksional për menaxhimin e të dhënave mbi operatorët, inspektimet dhe raportimet e bazuara në risk. Aplikimi i parimit të transparencës është i pjesshëm dhe Shqipëria nuk ka ende një plan kombëtar shumëvjeçar për kontrollet zyrtare, siç kërkohet nga acquis. Burimet financiare dhe njerëzore për AKU-në janë të pamjaftueshme, gjë që kufizon ndjeshëm kapacitetin për zbatim efikas të kontrollit ushqimor.³

Në fushën veterinare, Shqipëria nuk ka përafruar legjislacionin me standardet e BE-së mbi shëndetin e kafshëve. Reforma e sektorit është e paplotë, me mungesa në burimet njerëzore dhe në kapacitetet për mbikëqyrje pasive dhe aktive. Edhe pse janë ndërmarrë fushata për vaksinimin kundër tërbimit dhe monitorimi i brucelozës e tuberkulozit në tufat e gjedhëve, regjistrimi dhe gjurmueshmëria e kafshëve mbeten të dobëta. Regjistri nuk përfshin të gjitha llojet e kafshëve dhe nuk është i lidhur me sistemin e gjurmueshmërisë së produkteve me origjinë shtazore.

Sa i përket vendosjes në treg të ushqimeve dhe nënprodukteve shtazore, Shqipëria ka zbatuar një plan kombëtar për monitorimin e mbetjeve, por ai nuk është gjithëpërfshirës dhe mungojnë metodat e verifikimit për garantimin e cilësisë dhe sigurisë për të gjitha kategoritë e produkteve. Kapacitetet laboratorike janë të kufizuara, akreditimi

² European Parliament and Council. (2002, January 28). *Regulation (EC) No 178/2002 of the European Parliament and of the Council laying down the general principles and requirements of food law, establishing the European Food Safety Authority and laying down procedures in matters of food safety*. Official Journal of the European Communities, L 31, 1–24. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32002R0178>

³ European Commission. (2024). *Albania 2024 Report* (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf

është i pjesërishëm dhe mungojnë metodat moderne të analizës.⁴ Nuk ka përparim ligjor për menaxhimin e nënprodukteve shtazore. Edhe në aspektin e aditivëve dhe ndotësve në ushqim, përafrimi është vetëm parcial dhe mungon një plan veprimi për përmirësimin e cilësisë së qumështit, që mbetet një nga hallkat më problematike në zinxhirin ushqimor shqiptare.⁵

Në politikën fitosanitare, Shqipëria ende nuk ka miratuar ligjin kombëtar për shëndetin e bimëve. Është miratuar një plan monitorimi i dëmtuesve të bazuar në risk për vitin 2024, por nuk ka progres të dukshëm në detektimin dhe ç'rrenjosjen e tyre. Legjislacioni për ushqimin për kafshë dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht nuk është përafruar.⁶ Kjo tregon jo vetëm vonesa në aspektin teknik, por edhe mungesë të një qasjeje të integruar për menaxhimin e rreziqeve në bujqësi, ushqim dhe mbrojtjen e bimëve.

Në terma më të gjerë të integritit, Shqipëria gjendet në një pozitë sfiduese për përmbushjen e kërkesave të këtij kapitulli. BE-ja kërkon nga çdo vend kandidat jo vetëm përafrim të legjislacionit, por zbatim real të tij përmes strukturave operative, inspektimeve të bazuara në risk, laboratorëve të akredituar dhe pjesëmarrje aktive në sistemet e BE-së si Sistemi i Alarmit të Shpejtë për Ushqimin dhe Ushqimin e Kafshëve (RASFF) dhe Sistemi i Kontrollit Tregtar dhe Ekspert (TRACES). Deri më tani, Shqipëria ka bërë progres të pjesshëm në aspektin formal ligjor, por zbatimi i këtyre rregullave në praktikë mbetet i pamjaftueshëm.

Për të përmbushur Kapitullin 12, Shqipëria duhet të ndërmarrë një reformë të thellë strukturore dhe funksionale, ku së pari duhet të unifikojë sistemin e kontrollit ushqimor, të akreditojë laboratorët publikë, të zhvillojë një sistem elektronik kombëtar për gjurmueshmëri dhe të krijojë një plan shumëvjeçar për kontrole të bazuara në risk. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të matshme mund të arrihet

⁴ Food Safety News. (2024, November). *EU Commission reports on food safety in five countries.*

<https://www.foodsafetynews.com/2024/11/eu-commission-reports-on-food-safety-in-five-countries/>

⁵ European Commission. (2024). *Albania 2024 Report* (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf

⁶ Ibid.



përmbushja e këtij kapitulli kritik për shëndetin publik dhe integrimin evropian.

4. ANALIZA MBI KAPITULLIN 28, “MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETI PUBLIK”

Kapitulli 28 i *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian përqendrohet në mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetin publik, si dy fusha të ndërlidhura me standardin e jetesës, sigurinë e tregut dhe garantimin e të drejtave bazë të individit. Ky kapitull kërkon që vendet candidate të zbatojnë rregulla që sigurojnë jo vetëm mbrojtjen e interesave ekonomikë të konsumatorëve dhe sigurinë e produkteve, por edhe përgjegjësinë për produktet me defekte, eliminimin e imitimeve të rrezikshme dhe vendosjen e një kornize efektive për mbrojtjen e shëndetit publik në të gjitha dimensionet. Ai përfshin standarde të përbashkëta për kontrollin e barnave, gjakut, qelizave dhe organeve, kontrollin e duhanit dhe reagimin ndaj kërcënimeve shëndetësore ndërkufitare.

Në Shqipëri, nga viti 2024, politika e konsumatorit është në kompetencë të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe është miratuar strategjia 2023–2030 për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut.⁷ Megjithatë, mbetet e paqartë mënyra se si trajtohen ankesat e konsumatorëve, ndërkohë që mungon transparenca institucionale për performancën e Mbrojtja e Konsumatorit dhe shëndeti publik (CPC). Shqipëria ka përafruar pjesërisht legjislacionin për sigurinë e produkteve, por nuk është ende në përputhje me *acquis-in* e ri mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe përgjegjësinë për produktet me defekte. Mungesa e harmonizimit me sistemin Safety Gate e kufizon kapacitetin e vendit për të ndjekur produktet e rrezikshme jo-ushqimore në kohë reale, siç kërkohet nga BE.⁸

⁷ Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. (2024). *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023–2030*. <https://ekonomia.gov.al>

⁸ European Commission. (2024). *Albania 2024 Report* (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final, p.69 https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf



Në fushën e shëndetit publik, përkundër ekzistencës së një sistemi elektronik në fazë pilotimi për raportimin e të dhënave shëndetësore (HIS), Shqipëria përballlet me investime të ulëta në këtë sektor. Shpenzimet për shëndetin publik janë në rënie dhe përfaqësojnë vetëm 2.8% të PBB-së, ndërsa shpenzimet private të qytetarëve mbeten të larta. Vetëm 13% e fondeve janë alokuar për pajisje mjekësore gjatë periudhës 2014–2024.⁹ Sipas raportit të BE 2024, Shqipëria ka miratuar ligje për substancat me origjinë njerëzore, por përafrimi me *acquis* mbi barnat, pajisjet mjekësore dhe produktet veterinarë është i paplotë.

Në fushën e kontrollit të duhanit, ndalimi i pirjes së duhanit në ambientet publike zbatohet dobët. Shqipëria nuk ka ratifikuar ende Protokollin e OBSH për eliminimin e tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit dhe nuk ka përparim të mjaftueshëm në përafrimin me direktivat për produktet e duhanit. Lidhur me sëmundjet ngjitëse dhe kërcënimet ndërkufitare, mungon një plan i ri reagimi ndaj pandemive dhe nuk ka raportime të rregullta në ECDC.¹⁰ Këto boshllëqe minojnë kapacitetin e sistemit shëndetësor për t'u përballur me emergjencë.

Masat për reduktimin e konsumit të alkoolit dhe parandalimin e abuzimit me drogë janë të fragmentuara dhe sporadike. Shqipëria ka një plan për kontrollin e kancerit dhe programe depistimi për disa forma të tij, por mungon një regjistër kombëtar i kancerit dhe nuk ka qartësi nëse plani është i përafruar me iniciativën evropiane. Pavarësisht miratimit të Planit për Shëndetin Mendor 2023–2026,¹¹ kequshqyerja mbetet shqetësim, veçanërisht te fëmijët dhe gratë shtatzëna.

Sipas raportit të BE, në fushën e anti-korrupsionit, sistemi i shëndetit publik mbetet i cënueshëm. Edhe pse ekzistojnë mekanizma për gjurmimin e barnave dhe kontrole mbi prodhuesit farmaceutikë, mungon një vlerësim gjithëpërfshirës i riskut dhe masa të dedikuara për

⁹ Ibid p.70

¹⁰ Ibid p.70

¹¹ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2024). *Plani i Veprimt për Shëndetin Mendor 2023–2026*. <https://shendetesia.gov.al>



menaxhimin e korrupsionit në këtë sektor.¹² Shqipëria ka nevojë për përforsim të sistemeve të auditimit, transparencës institucionale dhe etikës në prokurim shëndetësor.

Për të përmbushur kërkesat e Kapitullit 28, Shqipëria duhet të avancojë jo vetëm në përafrimin formal të ligjeve, por edhe në ndërtimin e mekanizmave funksionalë të mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit publik. Kjo përfshin zhvillimin e sistemeve efektive të raportimit dhe reagimit, fuqizimin e strukturave inspektuese, rritjen e investimeve në shëndetësi dhe përafrimin e plotë me standardet e BE-së për produktet, barnat, të drejtat e pacientit dhe menaxhimin e emergjencave shëndetësore. Vetëm përmes këtyre masave, Shqipëria mund të avancojë me besueshmëri në këtë kapitull të rëndësishëm të negociatave për anëtarësim.

5. INCIDENTET DHE SKANDALET E SIGURISË USHQIMORE NË SHQIPËRI (2024–2025)

Viti 2025 ka shënuar një intensifikim të pashembullt të skandaleve ushqimore në Shqipëri, (Tabela nr.1) duke nxjerrë në pah dobësitë sistemike të infrastrukturës institucionale për sigurinë ushqimore dhe mungesën e zbatimit efektiv të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe janë shënuar incidente të shumta, nga produktet me pesticide dhe metale të rënda, te mishrat e kontaminuar me salmonellë e deri tek produkte të skaduara që rietiketohen nuk janë vetëm raste të izoluar, por tregues të një krize strukturore të thelluar. Skandalet e mishit të pulës dhe derrit të importuar nga Brazili, të cilët rezultuan të kontaminuar me salmonelë dhe salmonelë Typhimurium, janë raste tipike të mungesës së kontrollit të importit dhe mungesës së sistemit gjurmues.¹³

¹² European Commission. (2024). *Albania 2024 Report* (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final, p.69 https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf

¹³ Dita, (2024, 2 prill). *Skandali: 1 ton mish Brazili hyn nga Morina në Shqipëri si i therur në Kosovë në Janar*. Gazeta Dita. <https://gazetadita.al/skandali-1-ton-mish-brazili-hyn-nga-morina-ne-shqiperi-si-i-therur-ne-kosove-ne-janar/>

Shteti shqiptar, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ushqimit (AKU) dhe ISUV, ka treguar vonesë në reagim dhe mangësi në transparencën publike, duke lënë hapësirë për dyshime mbi korrupsionin dhe falsifikimin e dokumentacionit shoqëruës. Po ashtu, zbulimi i produkteve të skaduara me herët në magazina private në Vorë, të rietiketuar për t'u shitur si të vlefshme, thekson mungesën e një sistemi inspektimi të qëndrueshëm dhe të depolitizuar.¹⁴ Rasti nuk u zbulua nga kontrolli i brendshëm institucional, por nga operacione policore, gjë që tregon varësinë nga ndërhyrje të jashtme. Ndër rastet më të rënda janë ato që përfshijnë eksporte të produkteve bujqësore shqiptare të refuzuara nga vendet e BE-së për shkak të pranisë së pesticideve të ndaluara (si chlorfenapyr, acetamiprid) dhe metaleve të rënda (si nikel).¹⁵ Bllokimi i domateve, pjeshkëve dhe specave nga Kroacia dhe Sllovenia¹⁶ nuk është vetëm dëmtim ekonomik, por një sinjal i qartë për mosrespektimin e standardeve të BE-së.¹⁷

Këto raste përbëjnë pengesë të drejtpërdrejtë për hapjen e mëtejshme të kapitullit të negociatave për Sigurinë Ushqimore, Veterinare dhe Fitosanitare. Rasti i sekuestrimit të produkteve pa faturë është një masë e domosdoshme për formalizimin e tregut ushqimor, por në mungesë të një sistemi funksional kontrolli, masat represive nuk mund të jenë zgjidhje afatgjatë. Formalizimi duhet të shoqërohet me akreditim të plotë të laboratorëve, trajnim të vazhdueshëm të inspektorëve, sistem elektronik të gjurmueshmërisë dhe bashkëpunim të ngushtë me RASFF dhe autoritetet e BE-së.¹⁸ Skandalet ushqimore të vitit 2025 nuk janë thjesht dështime teknike, por dëshmi të një krize institucionale, ku siguria ushqimore rrezikohet nga paaftësia për të zbatuar ligjin, korrupsioni dhe mungesa e përgjegjshmërisë. Për të

¹⁴ Albeu. (2025). Skandali në Vorë: Ushqimet kishin skaduar në janar, u falsifikonin etiketat për t'u hedhur në treg – çfarë u sekuestrua? Albeu. <https://albeu.com/lajme/skandali-ne-vore-ushqimet-kishin-skaduar-ne-janar-u-falsifikonin-etiketat-per-tu-hedhur-ne-treg-u-sekuestrua/809768/>

¹⁵ European Commission. (2025, 27 gusht). Notification 2025.6541: Chlorfenapyr in tomatoes from Albania. RASFF. <https://webgate.ec.europa.eu/rasff-window/screen/notification/786092>

¹⁶ European Commission. (n.d.). RASFF — Rapid Alert System for Food and Feed: Search results. European Commission. <https://webgate.ec.europa.eu/rasff-window/screen/search?searchQueries=eyJkYXRllp7InN0YXJ0UmFuZ2U>

¹⁷ Ibid.

¹⁸ European Commission. (2024). Albania 2024 Report (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final, p. 88). https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf



garantuar integritetin e sistemit dhe për të mbrojtur konsumatorin shqiptar, është i nevojshëm një reformim rrënjësor, jo vetëm në strukturë, por në mënyrën e funksionimit, transparencës dhe llogaridhënies.

Tabelë nr.1. Incidente të sigurisë ushqimore (2024–2025)

Data	Produkti	Problemi i raportuar	Kush e zbuloi / veprimet
Dhjetor 2024 – Janar 2025	Mandarina / portokalle (eksport/import) ¹⁹	Chlorpyrifos / Phosmet mbi kufij të lejuar	RASFF, Italia, Kroacia, vende të BE; AKU reagoi
Mars- Prill 2025	Luleshtrydhe (import nga Greqia) ²⁰	Pesticide mbi kufij të lejuar (52 kg)	AKU, bllokim importi derisa të dalin analizat
Mars 2025	Fileto derri (import nga Brazili) ²¹	Prania e Salmonella	AKU bllokoi ngarkesën
Mars 2025	Fileto pule (~18 ton nga Brazili) ²²	Salmonella Typhimurium	AKU, ISUV; pjesërisht u hodh në treg; hetime nga Prokuroria/Tatimet
Maj 2025	Gramsh (produkte ushqimore lokale) ²³	Dyshime për Salmonelë	AKU / ISUV; diskutim publik mbi analizat
Prill 2025	Qumësht lokal (Lufra, Erzeni) ²⁴	Aflatoksinë M1 mbi normë	AKU konfirmoi disa mostra; debat publik për reagimin

¹⁹ European Commission. (2024, 11 dhjetor). Notification 2024.9133: Chlorpyrifos in clementines from Albania. RASFF. <https://webgate.ec.europa.eu/rasff-window/screen/notification/731490>

²⁰ Euronews Albania. (2025, 4 prill). Three strawberry shipments from Greece contaminated with dangerous pesticides enter Albania. <https://euronews.al/en/three-strawberry-shipments-from-greece-contaminated-with-dangerous-pesticides-enter-albania/>

²¹ BalkanWeb. (2025, 27 maj). Mishi i derit i ardhur nga Brazili shitej në fshetësi? Reagon AKU: janë asgjësuar mbi 4,5 ton në prani të autoriteteve. <https://www.balkanweb.com/mishi-i-derit-i-ardhur-nga-brazili-shitej-ne-fshehtesi-reagon-aku-jane-asgjësuar-mbi-4-5-ton-ne-prani-te-autoriteteve/>

²² Citizens.al. (2025, 29 mars). 18 tons of infected meat on the market, activists denounce: Food safety in collapse. <https://citizens.al/en/2025/03/29/18-tone-mish-i-infektuar-ne-treg-aktivistet-denoncojne-siguria-ushqimore-ne-kolaps/>

²³ Alert.al. (2025). "Luftë" me salmonelën, ç'ndodhi në Gramsh? Ekspertët analizojnë rastin, institucionet heshtin. <https://alert.al/25107-2/>

²⁴ Zëri. (2025, 28 prill). Lufra dhe Erzeni shiten në treg qumësht me aflatoksinë.

<https://zeri.ai/aktualitet/lufra-dhe-erzeni-shiten-ne-treg-qumesht-me-aflatoksine-i224992>

Prill 2025	Sheqer palme (import, Tajlandë përmes Holandës) ²⁵	Dioksid sqfuri mbi nivel të lejuar	RASFF; AKU mori njoftim
Qershor - Korrik 2025	Domate (eksport për Kroaci) ²⁶	Pesticid chlorfenapyr mbi normë	Kroacia bllokoi; AKU arrestoi administrator/inspektorë
Korrik 2025	Rietiketim mallrash Vore (716 koli) ²⁷	Rietiketim i produkteve të skaduara dhe me pas tregtimi i tyre	Operacion policor
Gusht - shtator 2025	Pjeshkë (eksport për Kroaci, 5.5 ton) ²⁸	Përqendrim i lartë i nikelit	Kroacia bllokoi; RASFF; AKU reagoi
Shtator 2025	Specat të kuq ²⁹	Nivele të larta të pesticideve si acetamiprid, formetanate dhe flonicamid.	RASFF; Sllovenia bllokoi

Burimi: Përpunuar nga autori.

6. SHPËRBËRJA E AKU-SË DHE REFORMIMI INSTITUCIONAL NË KONTROLLIN USHQIMOR

Shpërbërja e Agjencisë Kombëtare të Ushqimit (AKU) përbën një zhvillim të rëndësishëm institucional në fushën e sigurisë ushqimore në Shqipëri, duke reflektuar një krizë besueshmërie, funksionaliteti dhe përputhshmërie me standardet europiane. Ky vendim, i ndërmarrë nga qeveria shqiptare në korrik 2025, synon të adresojë dështimet

²⁵ Ekofin. (2025, 18 prill). Në Shqipëri është shitur 24 kg sheqer palmë i kontaminuar me dioksid sqfuri. <https://ekofin.al/ne-shqiperi-eshte-shitur-24-kg-sheqer-palme-i-kontaminuar-me-dioksid-sqfuri/>

²⁶ European Commission. (2025, 27 gusht). Notification 2025.6541: Chlorfenapyr in tomatoes from Albania. RASFF. <https://webgate.ec.europa.eu/rasff-window/screen/notification/786092>

²⁷ Albeu. (2025). Skandali në Vorë: Ushqimet kishin skaduar në janar, u falsifikonin etiketat për t'u hedhur në treg – çfarë u sekuestrua? Albeu. <https://albeu.com/lajme/skandali-ne-vore-ushqimet-kishin-skaduar-ne-janar-u-falsifikonin-etiket-at-per-tu-hedhur-ne-treg-cfare-u-sekuestrua/809768/>

²⁸ Politiko.al. (2025). Tre ngarkesa me rrush dhe pjeshkë me pesticide kanë hyrë në Shqipëri. <https://politiko.al/english/e-tjera/tre-ngarkesa-me-rrush-dhe-pjeshke-me-pesticide-kane-hyre-ne-shqiperi-i540934>

²⁹ European Commission. (n.d.). RASFF — Rapid Alert System for Food and Feed: Search results. European Commission. <https://webgate.ec.europa.eu/rasff-window/screen/search?searchQueries=eyJkYXRllip7InN0YXJ0UmFuZ2U>

sistemike të vërejtura ndër vite, përmes një riorganizimi të thellë institucional që synon konsolidimin dhe profesionalizimin e mekanizmave të kontrollit ushqimor.³⁰

AKU, si organ teknik nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë, ka pasur për mision garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit përmes inspektimeve të rregullta, analizave laboratorike dhe monitorimit të produkteve ushqimore nga prodhimi deri te konsumatori final. Megjithatë, kjo strukturë është përballur me kritika të vazhdueshme për mungesë transparence, efikasitet të ulët dhe ndikim të lartë politik në vendimmarrje. Ndër problemet më të theksuara ka qenë fragmentarizimi i përgjegjësiave mes institucioneve të ndryshme (AKU, inspektorë veterinarë, struktura tatimore), mungesa e laboratorëve të akredituar, si dhe boshllëqet në zbatimin e legjislacionit ekzistues. Ligji nr. 9863/2008 "Për ushqimin" ka mbetur pjesërisht i pazbatuar për shkak të mungesës së akteve nënligjore përkatëse, duke krijuar një vakum rregullator që ka penguar funksionimin efektiv të sistemit të sigurisë ushqimore.³¹

Për më tepër, shqetësime të përsëritura janë ngritur mbi cilësinë e produkteve në treg, sidomos përsa i përket mbetjeve të pesticideve dhe antibiotikëve në produktet e bulmetit rastet që i përmendem dhe në kapitullin më lartë. Raportet kombëtare dhe ndërkombëtare kanë evidentuar një nivel të ulët gjurmueshmërie, mungesë standardizimi në analizat laboratorike dhe mungesë të një sistemi të integruar informacioni.³² Të gjitha këto, përveçse përbëjnë rrezik për shëndetin publik, përbëjnë një pengesë reale për përmbushjen e kriterëve të integritetit evropian.

Në këtë kontekst, shkrimi i AKU-së dhe krijimi i një strukture të re vlerësohet si një akt reformues, i orientuar drejt rritjes së efikasitetit

³⁰ Top Channel. (2025, 6 prill). *Ligji i ri, shkrihet AKU! Unifikimi i Inspektorateve është direktivë e BE, çfarë pritet të ndodhë me punonjësit*. Top Channel. <https://top-channel.tv/2025/04/06/ligji-i-ri-shkrihet-aku-unifikimi-i-inspektorateve-eshte-direktive-e-be-çfare-pritet-te-ndodhe-me-punonjesit/>

³¹ Republika e Shqipërisë. (2008, 28 janar). *Ligj nr. 9863 "Për ushqimin"* (i ndryshuar). Marrë nga Qendra e Botimeve Zyrtare: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/01/28/9863>

³² European Commission. (2024). *Albania 2024 Report* (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final, p. 88). https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf

institucional dhe harmonizimit me *acquis communautaire* të Bashkimit European. Shqipëria ende nuk ka hapur negociatat për kapitullin "Siguria Ushqimore, Veterinare dhe Fitosanitare", ku kërkohet përmbushja e standardeve të BE-së si, zbatimi i sistemit HACCP³³, garantimi i gjurmueshmërisë së produkteve dhe kontrolli laboratorik i certifikuar.³⁴

Ndërhyrja e drejtpërdrejtë e qeverisë përmes masave të menjëhershme, përfshirë sekuestrimin e produkteve të bulmetit që qarkullojnë pa faturë, synon të forcojë formalizimin e tregut dhe të rivendosë disiplinën në zinxhirin ushqimor. Përgjegjësia e biznesit për të respektuar kërkesat ligjore është esenciale për të garantuar sigurinë e konsumatorit dhe për të përmirësuar konkurrueshmërinë e prodhimeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Megjithatë, suksesi i kësaj reforme do të varet nga aftësia e strukturave të reja për të siguruar integritet institucional, trajnimin e burimeve njerëzore, investimin në infrastrukturë laboratorike dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Reformimi nuk duhet të reduktohet në ndryshim emërtimesh apo riorganizim burokratik, por duhet të shoqërohet me standardizim të procedurave, rritje të kapaciteteve teknike dhe vendosje të një kulture të re të përgjegjshmërisë publike. Një sistem funksional i kontrollit nuk është vetëm kërkesë teknike, por është themelor për mbrojtjen e shëndetit publik, ndërtimin e besimit qytetar dhe sigurimin e një të ardhmeje europiane për Shqipërinë.

7. ANALIZA KRAHASUESE E SIGURISË USHQIMORE NË SHQIPËRI DHE VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Ky kapitull paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes së sigurisë ushqimore në Shqipëri në raport me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për vitin 2024-2025, bazuar në një metodologji vlerësimi me indikatorë të qartë, funksionalë dhe të matshëm. Qëllimi është të ofrohet një pasqyrë krahasuese e nivelit të përputhjes me kërkesat e

³³ Hazard Analysis and Critical Control Points, analizë e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit, metodologji bazë për parandalimin e rreziqeve në prodhimin dhe qarkullimin e ushqimit.

³⁴ Ibid. p.88.



Kapitullit 12 të *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, duke shqyrtuar kapacitetet institucionale dhe funksionimin praktik të mekanizmave të kontrollit ushqimor në secilin vend.

Qasja e përdorur në këtë analizë është ndërtuar mbi përvojat e monitorimit të European Food Safety Authority (EFSA), sistemit të alarmit të shpejtë për ushqim dhe ushqimit për kafshë (RASFF), si dhe kërkesave të specifikuara në Kapitullin 12 të *acquis communautaire*, që mbulon politikën për sigurinë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare. Janë përzgjedhur gjashtë indikatorë themelorë për të vlerësuar performancën e secilit vend:

- Përputhja me *acquis communautaire* – shkalla e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me rregulloret e BE-së.
- Gjurmueshmëria – aftësia për të ndjekur lëvizjen e produkteve ushqimore në të gjithë zinxhirin, nga origjina deri te konsumatori.
- Kapacitetet laboratorike – disponueshmëria dhe funksionimi i laboratorëve të akredituar për analiza të certifikuara.
- Kontrolli kufitar i bazuar në risk – zbatimi i sistemeve për kontroll të diferencuar doganor, në bazë të analizës së rrezikut.
- Transparenca dhe raportimi publik – niveli i dokumentimit dhe komunikimit të rasteve të shkeljeve, përfshirë përfshirjen në sisteme si RASFF.
- Tregu informal (indikator invers) – përqindja e qarkullimit të ushqimeve jashtë kontrolleve zyrtare, që reflekton nivelin e informalitetit.

Vlerësimi bëhet në një shkallë nga 1 në 5, ku:

- 1 = shumë i ulët / mungesë totale
- 2 = përputhje e pjesshme / fragmentare
- 3 = mesatar / me boshllëqe, por funksional
- 4 = përputhje e mirë / zbatim konsistent
- 5 = përputhje e plotë me standardet e BE



Tabela nr. 2 Vlerësim Krahasues (1–5)

Vendi	Përputhje me acquis	Gjurmueshmëri	Kapacitete laboratorike	Kontrollet kufitare (risk-based)	Transparencë / Raportim	Informalitet (Invers)
Shqipëria ³⁵	2 (E pjesshme)	2 (E pjesshme)	2 (E pjesshme)	2 (E pjesshme)	2 (E pjesshme)	1–2 (E pjesshme – E ulët)
Serbia ³⁶	3 (Mesatare)	3 (Mesatare)	3 (Mesatare)	3 (Mesatare)	3 (Mesatare)	2–3 (Mesatar)
Maqedonia e Veriut ³⁷	4 (E lartë)	3–4 (E mirë)	3 (Mesatare)	3 (Mesatare)	3 (Mesatare)	2–3 (Mesatar)
Bosnjë & Hercegovinë ³⁸	2–3 (Pjesshme–mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)
Mali i Zi ³⁹	3 (Mesatare)	3 (Mesatare)	3 (Mesatare)	3–4 (Mes./E lartë)	3 (Mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)
Kosova ⁴⁰	2–3 (Pjesshme–mes.)	3 (Mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)	2–3 (Pjesshme–mesatare)

Burimi: Përpunuar nga autori

Në vitin 2025, Shqipëria përballet me sfida të theksuara në menaxhimin e sigurisë ushqimore. Një sërë incidentesh me natyrë kritike, përfshirë ekspozimin ndaj pesticideve, rietiketimin e produkteve të skaduara dhe raste të importit me Salmonella, kanë evidentuar dobësitë e sistemit të kontrollit dhe kufizimet në infrastrukturën laboratorike dhe

³⁵ European Commission. (2024). *Albania 2024 Report* (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf

³⁶ European Commission. (2024). *Serbia 2024 Report*. https://enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2024_en

³⁷ European Commission. (2024). *North Macedonia 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North+Macedonia+Report+2024.pdf

³⁸ European Commission. (2024). *Bosnia and Herzegovina 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/451db011-6779-40ea-b34b-a0eeda451746_en?filename=Bosnia+and+Herzegovina+Report+2024.pdf

³⁹ European Commission. (2024). *Montenegro 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a41cf419-5473-4659-a3f3-af4bc8ed243b_en?filename=Montenegro+Report+2024.pdf

⁴⁰ European Commission. (2024). *Kosovo 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en

institucionale. Mungesa e një sistemi funksional të gjurmueshmërisë dhe ndarjet institucionale të paqarta mbeten pengesa kryesore për progresin.⁴¹

Në këtë kuadër, Serbia perceptohet si “mesatarisht e përgatitur”, ajo ka ngritur struktura horizontale që lidhin autoritetet veterinare, fitosanitare dhe shëndetësore.⁴² Megjithatë, vijon fragmentarizimi rregullator dhe sfidat në auditimet e brendshme. Maqedonia e Veriut ka bërë hapa domethënës në përafrimin e kornizës ligjore dhe në funksionimin e kontrolleve kufitare, por vuan nga mungesat buxhetore dhe kapacitetet e kufizuara laboratorike rajonale.⁴³ Bosnja dhe Hercegovina,⁴⁴ për shkak të arkitekturës së saj shtetërore shumë-nivelëshe, has vështirësi të natyrshme koordinimi, por raportet e importit/eksportit janë më të standardizuara, duke reflektuar përpjekje të qëndrueshme për të shmangur refuzimet nga tregjet e BE-së. Mali i Zi, me një treg më të vogël dhe volum të kufizuar import-eksporti, ka avantazhe relative në mbikëqyrje operative, por vuan nga efektet e shkallës në laboratorë dhe në trajnimin e personelit.⁴⁵ Kosova ka ecuri të dukshme në dixhitalizimin e disa proceseve të inspektimit dhe në ndërveprimin me konsumatorin, por mbetet e varur nga bashkëpunimi ndërkufitar për analiza të specializuara dhe referencë.⁴⁶ (Tabela nr.2)

Ajo që e veçon negativisht Shqipërinë nga vendet e tjera të rajonit është mungesa e një sistemi të unifikuar për gjurmueshmëri dhe

⁴¹ European Commission. (2024). *Albania 2024 Report* (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf

⁴² European Commission. (2024). *Serbia 2024 Report*. https://enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2024_en

⁴³ European Commission. (2024). *North Macedonia 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North+Macedonia+Report+2024.pdf

⁴⁴ European Commission. (2024). *Bosnia and Herzegovina 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/451db011-6779-40ea-b34b-a0eeda451746_en?filename=Bosnia+and+Herzegovina+Report+2024.pdf

⁴⁵ European Commission. (2024). *Montenegro 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a41cf419-5473-4659-a3f3-af4bc8ed243b_en?filename=Montenegro+Report+2024.pdf

⁴⁶ Food Safety News. (2024, nëntor). *EU Commission Assesses Progress in Potential Member States*. <https://www.foodsafetynews.com/2024/11/eu-commission-assesses-progress-in-potential-member-states/>



monitorim të bazuar në risk, që të lidhë operatorët ekonomikë, laboratorët, doganat dhe inspektoratet në kohë reale. Si pasojë:

- Incidentet zbulohen shpesh pas ndodhjes ose nga autoritetet e vendeve importuese.
- Mungon një komunikim publik i rregullt dhe i besueshëm për shkeljet, gjë që minon besimin e konsumatorëve dhe dëmton imazhin e operatorëve që i përmbahen rregullave.

Ndërkohë, vendet që kanë zbatuar HACCP (Analiza e Rreziqeve dhe Pikat Kritike të Kontrollit) në mënyrë të standardizuar, kanë integruar databaza institucionale dhe aplikojnë analiza risku në kontrollet doganore, arrijnë të minimizojnë ndjeshëm rrezikun që produkte të pasigurta të hyjnë në treg.

8. ANALIZË E PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTLIGJIT SHQIPTAR “PËR KONTROLLET ZYTARE” ME RREGULLOREN (BE) 2017/625

Projektligji shqiptar për kontrollet zyrtare në sektorin ushqimor është ndërtuar në bazë të parimeve themelore të legjislacionit evropian dhe demonstroi përputhshmëri të konsiderueshme me Rregulloren (BE) 2017/625. Ai mbështet objektivat kryesore të BE-së për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisit, duke reflektuar një vullnet të qartë politik për përafrim me *acquis communautaire*.

Fushat me përputhshmëri të plotë përfshijnë, përcaktimin e objektivit kryesor, përgjegjësinë e operatorëve, strukturimin e autoriteteve kompetente, dhe procedurat bazë të kontrollit zyrtar si kontrolli fizik, dokumentacioni dhe identiteti (Tabela nr.3) . Këto janë të përfshira në mënyrë të qartë dhe përputhen me nenet përkatëse të Rregullores së BE-së.



Megjithatë, disa boshllëqe kritike ligjore dhe zbatuese mbeten, veçanërisht në aspektet që lidhen me (Tabela nr.3) implementimin praktik dhe garantimin e standardeve të cilësisë:

- Auditimi i brendshëm dhe kontrollet pa paralajmërim mungojnë si dispozita eksplicite në projektligj, ndonëse janë elemente thelbësore të sistemit të kontrollit në BE.
- Trajnimi i stafit kontrollues përmendet vetëm në mënyrë të përgjithshme, pa specifikime mbi vazhdimësinë, dokumentimin dhe përmbajtjen sipas fushës, siç kërkon BE.
- Mekanizmat e transparencës publike, si publikimi i rezultateve të kontroleve dhe renditja e operatorëve sipas përputhshmërisë, si dhe ankesat dhe apelimet, nuk janë të strukturuar mirë në projektligj.

Tabela nr.3 Krasime të projektligjit Shqiptar me BE

Elementi	Projektligji Shqiptar 'Për kontrollet zyrtare' ⁴⁷	Rregullorja (BE) 2017/625 ⁴⁸	Përputhshmëria
Objekti kryesor	Neni 1 Mbrotjtja e shëndetit të njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisit	L95/1 – Neni 1 E njëjta, plus garanci për funksionimin e tregut të brendshëm	Plotësisht përputhet
Parimi i përgjegjësisë	Neni 2 Operatorët janë përgjegjës për respektimin e ligjit	L95/4 – Neni 13 Po, sipas nenit 13 të Rregullores	Plotësisht përputhet
Qasja e bazuar në risk	Neni 3 E përmendur në mënyrë të përgjithshme	L95/5 – Neni 32 E detajuar, përfshirë auditime të rregullta, frekuencë të	Pjesërisht përputhet, kërkon më shumë specifikime praktike

⁴⁷ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. (2025, 20 Gusht). "Në konsultim publik projektligji i ri 'Për kontrollet zyrtare', forcim i sigurisë ushqimore dhe përafrim me standardet e BE".

<https://bujqesia.gov.al/ne-konsultim-publik-projektligji-i-ri-per-kontrollet-zyrtare-forcim-i-sigurise-ushqimore-dhe-perafrim-me-standardet-e-be/>

⁴⁸ European Parliament & Council of the European Union. (2017). **Regulation (EU) 2017/625 of the European Parliament and of the Council of 15 March 2017 on official controls and other official activities performed to ensure the application of food and feed law, rules on animal health and welfare, plant health and plant protection products.** Official Journal of the European Union, L 95, 1–142 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017R0625>

		përshtatur sipas rezikut	
Delegimi i detyrave	Neni 26 I lejuar, përfshirë trupat e deleguara dhe personat fizikë	L95/8 – Neni 46 Po, por vetëm me kritere strikte për paanshmëri dhe akreditim	Mungon qartësim për akreditimin dhe mbikëqyrjen
Kontrolli pa paralajmërim	Jo i përmendur shprehimisht	L95/5 – Neni 33 BE kërkon që të mos paralajmërohen përveç rasteve të veçanta	Mungon dispozita
Trajnimi i stafit	Neni 102 I përmendur në mënyrë të përgjithshme	L95/5 – Neni 28 Rregullorja kërkon trajnim të vazhdueshëm dhe të dokumentuar sipas fushës	Pjesërisht përputhet
Auditimi i brendshëm	Neni 6 Eshtë i përgjithshëm nuk përcakton afatet kohore	L95/5 – Neni 29 BE kërkon auditim të rregullt dhe transparent për vetë institucionet	Pjesërisht përputhet
Publikimi i rezultateve të kontrolleve	Neni 11 Jo i detyrueshëm nuk përmend llogaridhënien direkte, por e nënkupton përmes transparencës	L95/6 – Neni 39 BE kërkon publikim të rezultateve dhe renditje të operatorëve bazuar në përputhshmëri	Mungon llogaridhënia ndaj publikut
Mekanizmat për ankesa dhe apelim	Jo të sqaruara	L95/5 – Neni 30 BE garanton të drejtën për apelim administrativ dhe gjyqësor	Mungon mekanizëm i qartë ligjor

Burimi: Përpunuar nga autori



9. GJETJET KRYESORE

1. **Përputhshmëria Ligjore është e pjesshme**, veçanërisht në Kapitullin 12, ku Shqipëria nuk ka ende një sistem funksional të gjurmueshmërisë dhe mungojnë planet shumëvjeçare të kontrollit zyrtar, ashtu siç kërkon Rregullorja (BE) 2017/625.
2. **AKU është shkrirë për shkak të dështimeve sistematike**, por krijimi i një strukture të re nuk është shoqëruar ende me riorganizim efektiv të kompetencave, standardizim të procedurave dhe rritje reale të kapaciteteve teknike.
3. **Skandalet ushqimore në vitin 2025 zbuluan mungesën e zbatimit të ligjit në praktikë**, me raste të përsëritura të pesticideve të ndaluara, salmonela në produkte importi dhe rietiketim të produkteve të skaduara. Gjatë periudhës 2024-2025 janë evidentuar 11 raste.
4. **Në fushën e shëndetit publik**, pavarësisht ekzistencës së strategjive (si plani për shëndetin mendor), mungojnë instrumentet e zbatimit dhe kontrollit, si dhe investimet janë në rënie (vetëm 2.8% e PBB-së).
5. **Nga analiza krahasuese rajonale del se Shqipëria renditet e fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor**, përse i përket nivelit të përgjithshëm të përputhjes me standardet e sigurisë ushqimore të parashikuara në Kapitullin 12 të *acquis communautaire*. Ajo shfaq vlerësime të ulëta (shkalla 1–2) në disa nga indikatorët më të rëndësishëm: gjurmueshmëria, kapacitetet laboratorike dhe transparenca institucionale, duke reflektuar një sistem të brishtë dhe të fragmentuar kontrolli. Në ndryshim nga vendet si Maqedonia e Veriut dhe Serbia, të cilat kanë ngritur struktura funksionale dhe zbatojnë sistemin HACCP⁴⁹. Shqipëria mbetet e ekspozuar ndaj identifikimit të vonuar të problemeve dhe mungesës së reagimit të shpejtë. Këto boshllëqe përbëjnë një pengesë reale për hapjen e Grupkapitullit 5 dhe vendosin në pikëpyetje aftësinë institucionale për të garantuar sigurinë ushqimore sipas kërkesave të BE-së.
6. **Ka një hendek të madh midis përafrimit formal të ligjeve dhe zbatimit real në terren**, ç'ka minon besueshmërinë institucionale dhe vonon përmbushjen e kriterëve të integritetit në të dy kapitujt , aq më tepër që Kapitulli 12 nuk është hapur ende dhe Kapitulli 28 është tashmë pjesë e kapitujve të negociuar.

⁴⁹ Hazard Analysis and Critical Control Points, analizë e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit, metodologji bazë për parandalimin e rreziqeve në prodhimin dhe qarkullimin e ushqimit.



10. REKOMANDIMET

1. Ndërtimi i një Sistemi Kombëtar Gjurmueshmërie me Platformë Dixhitale

Krijimi i një databaze të unifikuar në kohë reale që lidh prodhuesit, laboratorët, doganat dhe inspektorët për gjurmimin e çdo produkti nga origjina deri te konsumatori.

2. Akreditimi dhe Forcimi i Laboratorëve Publikë

Investime prioritare në pajisje moderne dhe staf të certifikuar për të përmbushur standardet e analizës sipas acquis, duke siguruar kapacitet të mjaftueshëm për kontroll të produkteve të brendshme dhe import/eksport.

3. Zbatim i Inspektimeve të Bazuar në Risk dhe Kontroll pa Paralajmërim

Riorganizimi i strukturave të kontrollit për të garantuar auditim të rregullt të operatorëve ushqimorë dhe kontroll të papritur për të rritur efikasitetin dhe për të ulur informalitetin.

4. Përafrimi i Plotë me Sistemet Evropiane – RASFF, TRACES, Safety Gate

Shqipëria duhet të integrohet funksionalisht në platformat evropiane të sigurisë, duke garantuar raportim dhe ndërveprim të menjëhershëm në rast shkeljesh ose kërcënimesh.

5. Reformim Real dhe Funksional i Strukturës Pas-AKU

Strukturat e reja të krijuara pas shkrirjes së AKU duhet të jenë të depolitizuara, të profesionalizuara dhe të orientuara drejt rezultateve konkrete, me transparencë ndaj publikut dhe llogaridhënie për çdo masë të ndërmarrë.



11. REFERENCA

Albeu. (2025). *Skandali në Vorë: Ushqimet kishin skaduar në janar, u falsifikonin etiketat për t'u hedhur në treg – çfarë u sekuestrua?* Albeu. <https://albeu.com/lajme/skandali-ne-vore-ushqimet-kishin-skaduar-ne-janar-u-falsifikonin-etiket-at-per-tu-hedhur-ne-treg-cfare-u-sekuestrua/809768/>

Alert.al. (2025). *"Luftë" me salmonelën, ç'ndodhi në Gramsh? Ekspertët analizojnë rastin, institucionet heshtin.* <https://alert.al/25107-2/>

BalkanWeb. (2025, 27 maj). *Mishi i derrit i ardhur nga Brazili shitej në fshehtësi? Reagon AKU: janë asgjësuar mbi 4,5 ton në prani të autoriteteve.* <https://www.balkanweb.com/mishi-i-derrit-i-ardhur-nga-brazili-shitej-ne-fshehtesi-reagon-aku-jane-asgjësuar-mbi-4-5-ton-ne-prani-te-autoriteteve/>

Citizens.al. (2025, 29 mars). *18 tons of infected meat on the market, activists denounce: Food safety in collapse.* <https://citizens.al/en/2025/03/29/18-tone-mish-i-infektuar-ne-treg-aktivistet-denoncojne-siguria-ushqimore-ne-kolaps/>

Dita, (2024, 2 prill). *Skandali: 1 ton mish Brazili hyn nga Morina në Shqipëri si i therur në Kosovë në Janar.* Gazeta Dita. <https://gazetadita.al/skandali-1-ton-mish-brazili-hyn-nga-morina-ne-shqiperi-si-i-therur-ne-kosove-ne-janar/>

Ekofin. (2025, 18 prill). *Në Shqipëri është shitur 24 kg sheqer palmë i kontaminuar me dioksid squfuri.* <https://ekofin.al/ne-shqiperi-eshte-shitur-24-kg-sheqer-palme-i-kontaminuar-me-dioksid-squfuri/>

Euronews Albania. (2025, 4 prill). *Three strawberry shipments from Greece contaminated with dangerous pesticides enter Albania.* <https://euronews.al/en/three-strawberry-shipments-from-greece-contaminated-with-dangerous-pesticides-enter-albania/>

European Commission. (2017). *Regulation (EU) 2017/625 on official controls and other official activities.* <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017R0625>

European Commission. (2024). *Albania 2024 Report (Commission Staff Working Document No. SWD(2024) 690 final,* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf

European Commission. (2024). *Bosnia and Herzegovina 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/451db011-6779-40ea-b34b-a0eeda451746_en?filename=Bosnia+and+Herzegovina+Report+2024.pdf

European Commission. (2024). *Kosovo 2024 Report* https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en



European Commission. (2024). Montenegro 2024 Report

https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a41cf419-5473-4659-a3f3af4bc8ed243b_en?filename=Montenegro+Report+2024.pdf

European Commission. (2024). North Macedonia 2024 Report

https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North+Macedonia+Report+2024.pdf

European Commission. (2024). Serbia 2024 Report.

https://enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2024_en

European Commission. (2024, 11 dhjetor). Notification 2024.9133: Chlorpyrifos in clementines from Albania. RASFF. <https://webgate.ec.europa.eu/rasff-window/screen/notification/731490>

European Commission. (2025, 27 gusht). Notification 2025.6541: Chlorfenapyr

in tomatoes from Albania. RASFF. <https://webgate.ec.europa.eu/rasff-window/screen/notification/786092>

European Food Safety Authority. (2025, 24 shtator). 2025 Eurobarometer on Food Safety in the EU.

<https://www.efsa.europa.eu/en/corporate/pub/eurobarometer25>

¹European Parliament & Council of the European Union. (2017). **Regulation (EU) 2017/625 of the European Parliament and of the Council of 15 March 2017 on official controls and other official activities performed to ensure the application of food and feed law, rules on animal health and welfare, plant health and plant protection products.** *Official Journal of the European Union*, L 95, 1–142 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017R0625>

European Parliament and Council. (2002, January 28). *Regulation (EC) No 178/2002 of the European Parliament and of the Council laying down the general principles and requirements of food law, establishing the European Food Safety Authority and laying down procedures in matters of food safety.* *Official Journal of the European Communities*, L 31, 1–24. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32002R0178>

Food Safety News. (2024, nëntor). *EU Commission Assesses Progress in Potential Member States.* <https://www.foodsafetynews.com/2024/11/eu-commission-assesses-progress-in-potential-member-states/>

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. (2025, 20 Gusht). “Në konsultim publik projektligji i ri ‘Për kontrollet zyrtare’, forcim i sigurisë ushqimore dhe përafrim me standardet e BE”. <https://bujqesia.gov.al/ne-konsultim-publik-projektligji-i-ri-per-kontrollet-zyrtare-forcim-i-sigurise-ushqimore-dhe-perafrim-me-standardet-e-be/>

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. (2024). *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023–2030.* <https://ekonomia.gov.al>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2024). *Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2023–2026.* <https://shendetesia.gov.al>



Politiko.al. (2025). *Tre ngarkesa me rrush dhe pjeshkë me pesticide kanë hyrë në Shqipëri*. <https://politiko.al/english/e-tjera/tre-ngarkesa-me-rrush-dhe-pjeshke-me-pesticide-kane-hyre-ne-shqiperi-i540934>

Republika e Shqipërisë. (2008, 28 janar). *Ligj nr. 9863 "Për ushqimin"* (i ndryshuar). Marrë nga Qendra e Botimeve Zyrtare: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/01/28/9863>

Top Channel. (2025, 6 prill). *Ligji i ri, shkrihet AKU! Unifikimi i Inspektorateve është direktivë e BE, çfarë pritet të ndodhë me punonjësit*. Top Channel. <https://top-channel.tv/2025/04/06/ligji-i-ri-shkrihet-aku-unifikimi-i-inspektorateve-eshte-direktive-e-be-çfare-pritet-te-ndodhe-me-punonjesit/>

Zëri. (2025, 28 prill). *Lufra dhe Erzeni shitën në treg qumësht me aflatoksinë*. <https://zeri.ai/aktualitet/lufra-dhe-erzeni-shiten-ne-treg-qumesht-me-aflatoksine-i224992>



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al